
unë kam një ëndërr,
të bëhem aktore,
të shkollohem,
të jem prezantuese,
të bëhem piktore,
të udhëtoj nëpër botë,
të jem modele,
të jem mjeke,
të bëhem politikane,
të bëhem gjyqtare,
të bëj jetë normale,
të jem arkitekte,
të bëhem balerinë,
të bëhem boksiere,
të jem e pavarur.

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit "Për rimëkëmbje dhe rindërtim pas tërmetit" zbatuar nga UN Women dhe mbështetur financiarisht nga qeveria suedeze përmes fondit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

@2022 UN Women

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Të drejtat e autorit për fotografitë: UN Women Albania & Jutta Benzenberg

Layout & Design: HL Branding

Fotografia: Jutta Benzenberg

Titulli:
UNË KAM NJË ËNDËRR

unë kam një ëndërr...

Projekti fotografik "Unë kam një ëndërr" i UN Women Shqipëri dhe Jutta Benzenberg, ilustron ëndrrat e të rejave dhe adoleshenteve shqiptare nga zonat e thella të vendit. Përballë kamerës, ato u çliruan nga elementet zakonore dhe normat patriarkale, duke përqafuar lirinë e ëndrrave të tyre për një të ardhme të arritshme.

Falë optikës së saj vëzhguese, empatike e intuitive, Benzenberg kap shpirtin e vërtetë të këtyre ëndrrave nëpërmjet një studimi soditës të syve të të rejave, teksa ato ia besojnë aspiratat e tyre kamerës. Befas, e largëta vjen afër, subjekti bëhet i vërtetë; portretet e panjohura shndërrohen në familjare, bashkë me mjediset e tyre të largëta e të kufizuara, duke u tjetërsuar kështu në një botë mundësish.

Këto fotografi nuk rrëfejnë thjesht histori, ato i mundësojnë shikuesit të kapërcejë gjendjen e spektatorit të thjeshtë dhe të zhvillojë një lidhje të vërtetë me personin që qëndron pas imazhit, me shpresat e saj, energjinë e saj dhe shfaqjen e vërtetë të qenies së saj. Tashmë, zërat e këtyre të rejave shqiptare mund të dëgjohen, dëshirat e tyre mund të ndjehen, aspiratat e tyre të kuptohen, qoftë nëse ato ëndërrojnë që të bëhen artiste, mjeke, avokate, apo thjesht gra të pavarura të forta që i bëjnë prindërit e tyre krenarë.

Ëndrrat e tyre frymëzuese do i gjeni të plota në fund të këtij publikimi. Duke dashur të mbrojmë privatësinë e tyre, qëllimshëm fjalët nuk përkojnë me fotot përpara jush. Është në dorën e shfletuesit/es të shijojë fotografitë dhe të ndërlidhë i/e lirë imazhet me ëndrrat.

Ky projekt nuk përfundon këtu. Ai është një thirrje ndaj shoqërisë për të drejta dhe shanse të barabarta, për të sfiduar stereotipat gjinorë. Është një lutje për të sheshuar hendekun që qëndron ndërmjet këtyre ëndrrave dhe realizimit të tyre.

Ky projekt fotografik është një nismë e UN Women Shqipëri, realizuar me mbështetjen e çmuar të Qeverisë Suedeze.

një ditë

para vështirësive



të ndihmoj njerëzit

Unë quhem Albiola dhe jetoj në fshatin Letaj. Ëndrra ime më e madhe është të bëhem një mjeke e suksesshme. Të kurosh dhe të ndihmosh njerëzit është diçka madhështore për mua. Do të isha shumë krenare nëse dikush atje jashtë do të ishte gjallë ose thjesht do të ndihej më mirë për shkak të punës sime të palodhur.

Unë quhem Nepa.
Ëndrra ime më e madhe është
të bëhem një grua e fortë,
ajo lloj gruaje që frymëzon.
Gjithashtu dua të jem një
mjeke e mrekullueshme.

të jem e lumtur

Unë jam Elsaeda nga Hasi dhe kam ëndërr të bëhem gjyqtare. Ma don zemra. Edhe pse jam e varfër dhe me prindër të divorcuar, kam mamin tim që më mbështet.

të jem

Endrra ime është të jem e pavarur,

Unë quhem Erta, jam motra e Fatmës dhe jetoj në fshatin Vajkal. Ëndrra ime është të jem e pavarur, të gjej një punë që më pëlqen ta bëj dhe të ndihmoj familjen time, të qëndroj pranë tyre dhe të jem aty për ta.

të gjej një punë që më pëlqen ta bëj.

pasiguritë

jetë normale

Unë jam Violeta nga fshati Xhuxhe. Ëndrra ime është të bëhem këngëtare. Sepse për mua është pasion dhe aty gjej vetveten dhe shfaq anën time shpirtërore.

mbizotëroj

grua

e fortë

një ndjenjë lirie

Jam Kasandra nga fshati Bisak. Gjithmonë kam dashur të bëhem balerinë, ndoshta ka qenë kontakti i parë me skenën që më ka bërë të dashurohem me pasion pas kërcimit. Është një ndjenjë e mrekullueshme lirie, pasioni dhe ndjenja më e bukur dhe më e pastër, ende e paplotësuar, por mendoj se asgjë nuk është e pamundur sidomos për një vajzë ambicioze.

me pasion

ma don zemra

ndry-shoj botën

të ndjej emocionet

Unë quhem Klejda nga Tirana dhe ëndrra ime është të jem aktore, të ndjej emocionet në skenë kur jam përballë mijëra njerëzve, të ndjej lumturinë që njerëzve u pëlqen kjo që bëj. Do të ndihesha kaq mirë.

gjej veten

e Tamshme

që frymëzon

Unë jam Veriona nga Mirdita! Kam dëshirë të bëhem aktore. Jo vetëm që më pëlqen shumë ky profesion, por jam e mendimit që mund t'ja dal sepse kam aftësitë e duhura për t'u bërë aktore.

Çdokush

ka një

ëndërr

Unë quhem Megi dhe jetoj në Kukës! Çdokush ka një ëndërr në jetën e tij të cilën dëshiron ta realizojë kur të rritet. Për të realizuar ëndrrën, duhet ta mbajmë në mendje dhe t'ia kujtojmë vetes çdo ditë. Por gjëja më e rëndësishme është të punosh shumë për ta bërë atë realitet. Ëndrra ime më e madhe nuk është të bëj një punë që më siguron shumë para, por të dua punën që do të bëj çdo ditë. Ëndrra ime më e madhe është të jem prezantuese në televizion, sepse sa herë që nis të prezantoj bota ime merr ngjyra të ndryshme dhe më shpërthejnë emocionet. Mendoj se kjo është ndjenja më e bukur dhe dua ta përjetoj këtë çdo ditë. Unë do të luftoj çdo ditë, kështu që një ditë të mund t'u them prindërve të mi "Po, kjo vajzë në TV është vajza juaj".

Unë do të luftoj çdo ditë

kembëngujë

të udhëtoj nëpër botë

Unë jam Sara nga Puka dhe ëndrra ime është të udhëtoj nëpër botë. Por tani për tani është herët për të folur për të ardhmen, pasi e tashmja nuk është dhe aq mirë, por shpresojmë për ditë më të mira.

s'ka fund

të gjitha ëndërrat tona

1

Unë quhem Klejda nga Tirana dhe ëndrra ime është të jem aktore, të ndjej emocionet në skenë kur jam përballë mijëra njerëzve, të ndjej lumturinë që njerëzve u pëlqen kjo që bëj. Do të ndihesha kaq mirë.

2

Jam Sindi dhe jetoj në fshatin Rëmenj. Jam një vajzë që jeta e ka vendosur përballë vështirësive. Gjithmonë kam dashur që një ditë të kem mundësinë të realizoj çdo ëndërr që kam dashur. Kam tepër dëshirë që të shkollohem që të kem një profesion. Jam munduar shumë që të përfundoj shkollën por rrethanat e kanë bërë të pamundur. Dua që një ditë të jem një parukiere, një profesion që e adhuroj pafund. Mundohem shumë që të mësoj gjëra të reja. Shpresoj që një ditë t'i realizoj të gjitha dëshirat e mija.

3

Unë jam Kristina dhe jetoj në fshatin Cërravë. Kam ëndërr të pikturoj, që një ditë të mund të bëhem piktore. Tani për tani vetëm shpresoj.

4

Unë jam Sara nga Puka dhe ëndrra ime është të udhëtoj nëpër botë. Por tani për tani është herët për të folur për të ardhmen, pasi e tashmja nuk është dhe aq mirë, por shpresojmë për ditë më të mira.

5

Kjo është Njomza nga fshati Peraj. Ëndrra ime është të bëhem sa më i suksesshme dhe aspiroj të punoj shumë për këtë! Ëndrra ime e fshehtë është të jem modele. Por çfarëdo rruge që do të zgjedh të ndjek, do të punoj shumë për të qenë e suksesshme.

6

Unë jam Kleisia dhe jetoj në fshatin Shushicë. Ëndrra ime është të bëhem aktore. Të jesh në skenë dhe duartrokitjet e publikut janë diçka shumë e bukur dhe e veçantë, por mendoj se do të mbetet vetëm një ëndërr. E di që të gjesh një punë si aktore nuk është e lehtë. Për këtë arsye mendoj se profesioni im në të ardhmen do të jetë në fushën e mjekësisë, pasi ka mundësi të mëdha punësimi.

7 (Dy motra)

Unë quhem Albiola dhe jetoj në fshatin Letaj. Ëndrra ime më e madhe është të bëhem një mjeke e suksesshme. Të kurosh dhe të ndihmosh njerëzit është diçka madhështore për mua. Do të isha shumë krenare nëse dikush atje jashtë do të ishte gjallë ose thjesht do të ndihej më mirë për shkak të punës sime të palodhur.

Unë quhem Nepa. Ëndrra ime më e madhe është të bëhem një grua e fortë, ajo lloj gruaje që frymëzon. Gjithashtu dua të jem një mjeke e mrekullueshme.

8

Unë jam Elsaeda nga Hasi dhe kam ëndërr të behem gjyqtare. Ma don zemra. Edhe pse jam e varfër dhe me prindër të divorcuar, kam mamin tim që më mbështet.

9

Unë quhem Jasemina nga Bajram Curri. Ëndrra ime më e madhe ka qenë gjithmonë arritja e suksesit në fushën e artit si artiste e kompletuar. Për mua arti është gjithçka, më duket se ka lindur dhe rrjedh në venat e mia. Arsyeja pse pikturoj është sepse piktura tregon saktësisht atë që nuk mund të them me fjalë, atë që jam, çdo gjendje timen emocionale dhe shpirtërore. Në vitet në vijim e shoh veten si një artiste e vërtetë diku jashtë Shqipërisë, sepse më duket e vështirë ta realizoj ëndrrën time këtu. Jam e bindur se do të luftoj për të arritur majat në fushën e artit dhe në të ardhmen do të bëj krenare veten dhe prindërit e mi. Arti nuk shpjegohet, arti kuptohet... ashtu si ëndrrat nuk mund të shpjegohen, vetëm ata që i kanë përjetuar mund t'i ndjejnë vërtet ato!

10

Unë jam Amalia nga Përmeti dhe nuk kam ndonjë ëndërr të madhe. Unë thjesht dua të bëhem infermiere dhe të bëj një jetë normale.

11

Përshëndetje, unë jam Megi nga fshati Piskovë dhe dua të bëhem mjeke, me shumë punë dhe dëshirë.

12

Unë jam Bonjana, jam19 vjeç dhe vij nga Tropoja. Gjatë gjithë jetës sime kam thurur shumë ëndrra dhe për momentin po mundohem t'i realizoj. Zgjodha që ëndrrat e mia t'i vazhdoja në një shtet tjetër, pasi Shqipëria nuk të jep shumë mundësi, këtë vit kam filluar studimet për infermieri në Gjermani. Shpresoj shumë që ky profesion të ndihmojë shumë njerëz dhe kjo është arsyeja kryesore që e fillova.

13

Unë jam Melisa nga Bulqiza. Kam menduar gjatë për të ardhmen time dhe më në fund vendosa. Dua të behem arkitekte, e kam këtë dëshirë pasi ky profesion më tërheq shumë. Dua që studimet t'i vazhdoj jashtë qytetit ku jetoj. Shpresoj që dëshira ime të realizohet një ditë.

14

Unë jam Violeta nga fshati Xhuxhe. Ëndrra ime është të bëhem këngëtare. Sepse për mua është pasion dhe aty gjej vetveten dhe shfaq anën time shpirtërore.

15

Unë quhem Erta, jam motra e Fatmës dhe jetoj në fshatin Vajkal. Ëndrra ime është të jem e pavarur, të gjej një punë që më pëlqen ta bëj dhe të ndihmoj familjen time, të qëndroj pranë tyre dhe të jem aty për ta.

16

Unë jam Fatma, motra e Ertës dhe jetoj në fshatin Vajkal. Ëndrra ime kur të rritem është të bëhem një stiliste e famshme dhe e suksesshme. Të dizenjoj rroba për të gjithë njerëzit. Të jem e lumtur pranë familjes time.

17

Jam Kasandra nga fshati Bisak. Gjithmonë kam dashur të bëhem balerinë, ndoshta ka qenë kontakti i parë me skenën që më ka bërë të dashurohem me pasion pas kërcimit. Është një ndjenjë e mrekullueshme lirie, pasioni dhe ndjenja më e bukur dhe më e pastër, ende e paplotësuar, por mendoj se asgjë nuk është e pamundur sidomos për një vajzë ambicioze.

18

Unë jam Luisa, jetoj në Tiranë. Ëndrra ime është të jem modele, dicka që në Shqipëri më duket pak e pamundur. Shpesh duhet të kesh lidhjet e duhura dhe një fytyre të caktuar. Megjithatë, gjithmonë më kanë pëlqyer sfilatat, të bërit foto dhe modelimi në përgjithësi, sidomos sepse më është dukur si një mundësi për të luftuar pasiguritë e mia. Kështu, në një botë ku kam qenë gjithmonë «më e dobët seç duhet», modelet kanë qenë një frymëzim për mua. Prandaj, duke qenë se kam vendosur të studioj jashtë Shqipërisë mendoj se ëndrrën time do ta bëj të mundur atje

19

Unë quhem Elsidita dhe jam nga Shkodra. Ëndërroj të bëhem një boksiere me arritje ndërkombëtare. Në Shqipëri stërvitem me djem sepse nuk kemi vajza në boks, ndaj nuk kam konkurrencë këtu. Boksi është më shumë se një sport për mua, është në harmoni të përsosur me personalitetin dhe gjendjen time mendore, pasi nga jashtë mund të dukem si agresive, por brenda jam e mbushur me pasion dhe dashuri. Për mua boksi nuk është vetëm një ëndërr, është një qëllim jete. Këmbëngulja ime për të sfiduar mentalitetin që i sheh vajzat si të brishta dhe jo të forta sa duhet, më ka ndihmuar të kem sukses deri më tani dhe të mos heq dorë nga ëndrra ime. Trajneri im thotë "grushti nuk ka gjini". Kjo moto më ka bërë që të fitoj medalje evropiane dhe do më shoqërojë gjithmone.

20

Unë quhem Uarda, jetoj në Vorë. Ëndrra ime është të bëhem një modele e famshme. Nëse kjo nuk funksionon, do të bëhem ekonomiste.

21

Unë jam Sara nga Mallakastra dhe ëndërroj të vazhdoj studimet në fushën e mjekësisë dhe të kem një karrierë të suksesshme.

22

Unë jam Amarda dhe jetoj në Kamëz. Unë ëndërroj për një të ardhme të suksesshme në mënyrë që të bëj veten dhe familjen time të lumtur dhe të jem një person i suksesshëm. Ëndërroj të studioj për mjekësi apo drejtësi sepse janë profesione fitimprurëse dhe luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e njerëzve. Unë gjithashtu ëndërroj të jem një person i sinqertë dhe optimist.

23

Unë jam Veriona nga Mirdita! Kam dëshirë të bëhem aktore. Jo vetëm që më pëlqen shumë ky profesion, por jam e mendimit që mund t'ja dal sepse kam aftësitë e duhura për t'u bërë aktore.

24

Unë jam Eleni dhe jam me origjinë nga Gramshi por jetoj në Gjergjan, Elbasan. Unë dua të bej kurs për parukiere dhe thonj. Më pas pasi të mbaroj kursin dua të hap një sallon bukurie timin. Dua të përfundoj fakultetin juridik dhe të bëhem avokate. Do të kem një zyrë timen ku të punoj dhe të zhvilloj punën time me pasion. Kjo dëshirë për drejtësi më vjen sepse kohët e fundit drejtësia nuk është siç do duhej. Dua që me punën time të bëj një gjë ndryshe për vendin tim e të ndihmoj njerëz të pafajshëm.

25

Unë quhem Megi dhe jetoj në Kukës! Çdokush ka një ëndërr në jetën e tij të cilën dëshiron ta realizojë kur të rritet. Për të realizuar ëndrrën, duhet ta mbajmë në mendje dhe t'ia kujtojmë vetes çdo ditë. Por gjëja më e rëndësishme është të punosh shumë për ta bërë atë realitet. Ëndrra ime më e madhe nuk është të bëj një punë që më siguron shumë para, por të dua punën që do të bëj çdo ditë. Ëndrra ime më e madhe është të jem prezantuese në televizion, sepse sa herë që nis të prezantoj bota ime merr ngjyra të ndryshme dhe më shpërthejnë emocionet. Mendoj se kjo është ndjenja më e bukur dhe dua ta përjetoj këtë çdo ditë. Unë do të luftoj çdo ditë, kështu që një ditë të mund t'u them prindërve të mi "Po, kjo vajzë në TV është vajza juaj".

26

Unë quhem Alkida dhe jam nga Thumana. Ëndrra ime është të bëhem politikane dhe të ndërtoj një shtet vetëm me vajza e gra dhe ku të mbizotërojë gruaja! Do të ishte një gjë e mahnitshme për mua!

27

Unë quhem Anfrila dhe vij nga Vau-Dejës. Ëndërroj të jem e lumtur me veten!!
Në këtë botë dinamike dhe diverse, ku mundësia dhe koha kushtuar vetes është e pamjaftueshme, dëshiroj që në kulmin e realizimit tim personal edhe profesional, të ndihem e qetë dhe e lumtur me veten. Dua që t'i njoh shumë mirë kënaqësitë e mia dhe të mos ngurroj, por t'i shijoj ato!

28

Unë quhem Sara dhe jam nga Mirdita. Ëndrra ime është të bëhem fotografe që të bëj foto të bukura. Kjo është diçka që më mahnit pamasë!

29

Unë jam Fjolla dhe jam nga Puka. Ëndërroj të bëhem kirurge dhe të ndihmoj çdo njeri në nevojë. Për mua kjo do të ishte mrekullia vetë!

Sweden
Sverige

UNITED NATIONS
ALBANIA

UN WOMEN